

Mr. Ismail DODA, Tivar

SKËNDERBEU NË TRADITËN POPULLORE SHQIPTARE NË MALIN E ZI

Figura madhështore e Skënderbeut, trimit të pashoq, mendjemprehtë, shpirtmirë, por mjaft i ashpër dhe i vendosur ndaj luftës me pushtuesit, i siguroi vetes dhe popullit shqiptar vend nderi në historinë e zhvillimit njerëzor. Si një strateg i madh, në krye të kombit dhe shtetit, i përballoi mbi njëzet fushata të rrepta, të ndërmarra nga armiku, i frymëzoi shekuj me radhë historianët, letrarët dhe krijuesit tjerë, jo vetëm shqiptarë e ballkanas, por edhe ata evropianë e më gjerë që t'i shkruanin më tepër se 1000 vepra në më shumë se 20 gjuhë. Një varg autorësh përmes heroit shqiptar pasqyruan idealet e burrërisë, trimërisë, nderit dhe besës të gjitha virtytet e shqiptarëve.¹



Tradita, burim dhe frymëzim

Edhe populli shqiptar i doli hakut këtij personaliteti të madh, që për kohën ishte i pazëvendësueshëm, duke e skalitur në kujtesën e vet. Kjo provohet dhe dëshmohet edhe nga shembujt e traditës gojore të viseve shqiptare më të skajshme veriperëndimore (në Malin e Zi të sotëm). Shëmbëlltyrën e Skënderbeut, i cili i vizitoi disa nga këto vise dhe u përpoq që t'i çlirojë dhe t'i përfshijë në shtetin e parë të bashkuar shqiptar, bërësit e traditës së këtushme, si pjesë e asaj gjithëkombëtare, duke e ruajtur dhe trashëguar e shndriti brez pas brezi, me anë të: 1. Lëndës folklorike dhe 2. Lëndës etnografike.

Dëshmi folklorike

Reflektim sipas gojëdhënave popullore

Gojëdhëna mbi vendet kur ruhen a ku fshehën sasi të mëdha florinjsh rëndom nën ndonjë rrasë të madhe guri, e njohur edhe tek popujt e botës, në këto anë lidhet me treva të Malësisë së Madhe: me Trieshin²; me Malin e Kakarriqit³; me lumin e Cemit⁴; me Dinoshën⁵; pastaj me trevat bregdetare: me limanin e Valdanosit afër Ulqinit⁶ dhe vende tjera. Por kulmin e lashtësisë e zë mbi Shasin, qytetin e njohur mesjetar të Anës së Malit, i cili më 1360, duke u mbështetur në masat e qytetarëve, ashtu si Durrësi, e pastaj Shkodra, Ulqini, edhe Shasi e shkundi saçin e huaj dhe u kthye në bashkësi qytetare (comuna civitatis) të pavarur.⁷ Rrënjët e saj historike lidhen me heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun. Në bazë të kopjes së një dokumenti të ashtuquajtur “testament” mësojmë se Skënderbeu e kishte fshehur thesarin përballë Bunës në kufirin turk. Atë shënim ia kishte dërguar një ulqinak i nderuar në vitet’20 të shekullit XX etnologut të njohur kuças, Stevan Duçiqit. Ulqinaku njëkohësisht e thirri që, mbi bazën e këtij shënimi të kërkonin bashkë thesarin e fshehur. Në shënimin e botuar në gjuhën serbe, aty-këtu i ngarkuar edhe me ndonjë fjalë arkaike dhe stil jo aq të rrjedhshëm, që e japim të përkthyer shqip, shkruan tekstualisht kështu:

“Testament. Në një saranxhë në Shas gjenden tre kazanë me florinj në të cilët zënë vend nëntëdhjetë okë ujë, dhe në të njëjtit kazanë gjenden shpata, kurora dhe kryqi, që secila nga ato vlen sa krejt kazani me dukat. Ky është një vend në një rrafshinë, ashtu edhe rreth tij janë tre shenja të gdhendur në gurë: kazma, në tjetrën nga lindja shati, kurse në tjetrin lumi. Poshtë rrafshinës gjendet burimi nga i cili dimrit bluan mulliri, kurse verës nuk mund të bluhet se ai shteret. Përballë tij është kisha e Shën Shpëtimtarit. Ky thesar i është lënë tokës amanet, që mos t’ia lëshojë askujt përveç në ditën e Shën Gjonit, para ditës së Shën Pjetrit, pikërisht gjatë asaj kohe prej mesnate në prag të Shën Gjonit deri në mesnatën e së njëjtës ditë. Që në fillim të çeljes, duhet t’i premtohet me be Shën Gjonit, se po ndërtohet kisha me gjithë anekset tjerë. Në pragun e kësaj çeljeje do të theret galani i patredhur dhe do të merret në dorë shishja e bardhë prej një oke plot me ujë”.

Në riprodhimin e këtij testamenti thuhet: “Atij që shkon sot në Shën Pjetër ia dorëzon dhe ia le amanet guvernator Skënderbeu, me

rastin e humbjes së tij, atë që nuk e fshehu në depo, shkoi në vendin e quajtur Shes, që është aty i fshehur te kisha e Shën Shpëtimtarit: tre kazanë dukat, dy janë plot, kurse i treti në gjysmë dhe i plotësuar me gjeranë të shenjtë dhe sende tjera antike. Aty janë këto shenja: prej kishe nga lindja mund të shihet lehtë në shkëmbinj këmba, shuplaka e lopata; prej gurit merr pak nga e majta, aty janë fshehur të tre kazanët, të cilët janë të lidhur me zinxhir, në zinxhir është dryni. Qemeri rri në këmbë në një thellësi prej nëntë kutesh. Në gur dy shenja. Rrëzë tij gurgullon uji dhe quhet Burim uji mineral (në tekst: Slatina, vër. I.D.) Në këtë depo vyen të thëret një dash i zi pa shenja, i tredhur. Në qoftë se çohet ndonjë erë, askush mos të frikësohet. Atij shoku që nga kjo shoqëri i pari i bie pllakës t'i jepen njëqind dukate më shumë se tjerëve. Qemerin që është amanet ta ndajë me perandorin, dhe nga njëqind dukate t'i jepen pesë. Pengjet e kishës që gjenden aty në kishin siberiane të Shën Gjonit dhe në të njëjtin vend kishës së Shën Shpëtimtarit, pjesa tjetër t'i ndahet shoqërisë. Por duhet të shkojnë në atë vend dymbëdhjetë njerëz besimtarë dhe një prift që të thotë uratë për dymbëdhjetë mjeshtrit e therur, të cilët janë varrosur aty, pasi e kanë ndërtuar qemerin në mënyrë që mos ta zbulojnë këtë libër.

Në zonjën e verës 1396, data 20 gusht”.⁸

Studiuesi Stevan Duçiqi ka meritë që e zbuloi, e regjistroi dhe më në fund, më 1931 e botoi këtë gojëdhënë të rëndësishme për traditën popullore të këtyre viseve dhe më gjerë. Për fat të keq studiuesi nuk ofron të dhëna për personin që ia dha “testamentin” e as për burimin e parë të tij. S’e dimë kush e shënoi i pari, cila ishte gjuha e treguesit dhe në cilën gjuhë e tregoi ai. Këto shënime do t’ia ngritin edhe më tepër vlerën shkencore. Materialin e përkthyer në gjuhën standarde shqipe. Të gjitha këto rrethana e largojnë tekstin nga burimi i saktë gjuhësor dhe e folmja dialektore e mjedisit ku u krijua. Sido që të jetë puna gojëdhëna e ka burimin tek Shasi mesjetar. Ky mjedis i lashtë iliro-arbëroro-shqiptar e ruajti për shumë shekuj legjendën e bukur dhe të plotë për Skënderbeun dhe periudhën e tij, duke e zgjeruar shtrirjen gjeografike në ekstremin veriperëndimor shqiptar. Kjo na jep shkas dhe na shtynë të pohojmë se ky krijim në radhë të parë i takon kulturës popullore shqiptare që dëshmohet nga shumë faktorë.

Të dy këto motërzime e plotësojnë njëri-tjetrin. Ato, krahas elementit historik i shtjellojnë edhe dy motive të rëndësishme për letërsinë gojore shqiptare:

Motivi i parë dhe kryesor është ruajtja dhe përpjekja për ta zbuluar dhe shti në dorë thesarin e fshehur brenda një periudhe shumë të gjatë kohore. Elementi fantastik me të cilin është ndërthurur dhe gërshetuar motivi përmban elemente shprehëse artistike. Ata e tërheqin lexuesin dhe e nxisin shkrimtarin që të përdorë në ndonjë krijim të tij. Elementi historik bëhet i njohur përmes emërvendit të lashtë, Shasit dhe disa nga kishat që përmenden aty, ku numri i tyre është baras me atë të ditëve të një motmoti. Është fakt se, nëse krijimet gojore shënohen me një vonesë shekullore, ata mund të humbasin fare, ose së paku të pësojnë ndryshim. Andaj edhe në motërzimin e dytë të legjendës, sa i përket datës hetohet një ndërlitim. Në fund të saj jepet data 20 gusht 1396, një vit para se i ati i tij Gjon Kastrioti të bëhet princ i Krujës (1395) që i bie nëntë vjet para vitit 1405, kur mendohet të ketë lindur Skënderbeu,⁹ të cilit i dedikohet. Emri i këtij strategu si kryepersonazh i gojëdhënës e lidhë edhe më fortë motivin e saj me mesjetën tonë historike që nuk është ndriçuar sa duhet. Pas emrit të Skënderbeut jepet ofiqi zyrtar guvernator që e ka edhe një bazë historike.¹⁰ Ky i shkon për shtat se vërtetë se ai e drejtoi dhe e qeverisi shtetin e parë të bashkuar shqiptar¹¹ me kryeqytet Krujën. Për rrethanat historike të kohës ai ishte një kryetar i mirëfilltë. Kjo dëshmohet edhe nga pajimet personale, objektet e tij – kurora dhe shpata që mendohet t'i ketë fshehur aty me gjithë thesarin sa ishte vetë gjallë. Të gjitha këto prova e vërtetojnë afërsinë e sundimitarit dhe komandantit të lavdishëm shqiptar me këto anë. Ai për një çerek shekulli jo vetëm vendin e vet, por edhe një pjesë të Ballkanit e solli mbarë, duke iu prirë në luftërat për liri dhe pavarësi. Shpata e tij që përmendet në legjendë ka edhe mbështetje reale. Gjithnjë këndohet në Malin e Zi një këngë popullore për një shpatë që ia dhuroi Skënderbeu njërit nga princërit e këtushëm si simbol i luftës së përbashkët kundër pushtuesve të Ballkanit, e cila nga koha e princ Danilos (vladika Danilo) u ruajt në shtëpi të Njegoshit që më vonë mbreti Nikolla Petroviq (Petrovic) ia dhuroi Blazho Boshkoviqit (Blazo Boskovic), me dëshirë që trimi i njohur malazias ta përdorte si dikur Skënderbeu¹². Gjërat më të vyera, përkrenarja dhe dy shpatat e Skënderbeut tani ndodhen në Muzeun e Historisë së Artit” në Vjenë (Kunsthistorisches Museum, Wien)¹³

Skënderbeu ishte mjeshtër i përsosur në përdorimin e shpatës. Ai me shpatë në dorë ia solli lirinë popullit të vet. Me të bënte edhe të paarritshmen. Kështu një ditë, në luftë e sipër me pushtuesit osman rreth kalasë së Krujës, kur ushtarët i mbetën etshëm: “Skënderbeu

mjedis shpell's i suell shpatë shkamt edhe aty del ujtë. U mblodh ushtria dhe piu ujë e u ngi”¹⁴

2. Motivi i dytë i legjendës lidhet me atë të murimit. Ai këtu paraqet një risi. Për dallim nga balada e murosjes së gruas, e përhapur edhe në këto anë dhe e lidhur me kështjellën “Rozafa” të Shkodrës, që s’është larg nga Shasi¹⁵ dhe me murosjen e një gruaje, sipas kësaj gojëdhëne (e cila si krijim gojor i prinë baladës) të Shasit në fillim të ndërtimit u bë kurban një dash, ashtu siç vazhdon të praktikohet kur fillon ndërtimi i një shtëpie, duke kujtuar se kjo do të sjellë mbarësi; pas ndërtimit të qemerit të depos ku, sipas legjendës, ndodhej thesari i fshehur në Shas, theren dymbëdhjetë mjeshtër, në mënyrë që mos të hetohet sekreti. Përveç elementit fantastik që i ka hije një gojëdhëne, pa kaluar në idealizim a mistifikim, edhe ky motiv ka rreze historike. Edhe sot, madje nëpër shtete të përparuara, për ta ruajtur sekretin e ndonjë objekti strategjik ushtarak e shtetëror, në mënyrë misterioze e pëson ndonjë nga ndërtuesit kryesor.

Gojëdhëna për lidhjet farefisnore, ka të bëjë me drekallët shqiptarë, më vonë të sllavizuar dhe të mbiquajtur Drekalaoviç, të fisit Kuç, nga fshati Kosor-i, prej të cilëve, nga shtatë vëllezër sa ishin, u zhvilluan shtatë fise, duke mbajtur emrin e tyre (Petroviç, Popoviç (Mirceta-Pop), Ivanoviç, Vuksanoviç dhe Milaçiç) që burojnë nga Kastriotët.¹⁶

Krahina e Kuçit, sipas një dokumenti te shek. XVII (viti 1614) ishte e banuar nga malësorë shqiptar, shumica me besim ortodoks. Sipas dokumentit të 5 majit 1774, krahina e Kuçit, tri orë afër qytetit të Podgoricës, ishte “vend shumë i fortë dhe i banuar i gjithë nga ortodoksë e katolikë, të cilët formojnë rreth njëmijë e dyqind pushkë. Kjo krahinë është pjesë e Malësisë së Madhe.”¹⁷

Për një prejardhje malësore (Malisori), përkatësisht shqiptare (Arbanasi), flasin në Zalef të Tivarit: Dushani¹⁸ dhe Vojisllavi¹⁹ të bijtë e Teodor Petroviqit,²⁰ duke i njuhur brezat nga i ati i tyre: Teodor/ Punishë/ Novak/ Radovan/ Lako/ Tomo/ Joko/ Petar/ Iliko/ Lale Drekale e tej, deri te një stërgjysh shumë i lashtë, përmes të cilit lidhen me farefisnin me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Në vazhdim ata shtojnë se, në bazë të traditës, pas vdekjes së Skënderbeut, kur osmanët e pushtuan Shqipërinë, iu kanosën Kastriotëve se do t’i shfarosin që të gjithë, duke ua therur, madje, edhe gratë shtatzëna. I biri i Skënderbeut, Gjoni, iku me një pjesë të popullit shqiptar në Itali. E shoqja shtatzënë i ngeli në Shqipëri. Ajo së pari u fsheh në Kastrat, në gjini. Prej andej, e veshur me rroba lypësi kaloi në Selcë, ku ia

tregoi të vërtetën mikpritësit të saj. Aty i lindi djali që e pagëzuan me emrin Drekalë (Ndrëkë). Për të mos rënë në duar të turqve, nga Selca fshehtazi, u vendos në fshatin Bezjovë (Bezjovo) të Kuçit, të njëfarë Nikeza Marini. Pasi e mur vesh se ajo ishte e reja e Skënderbeut, që po ikte nga pushtuesit osmanë nga frika se do t'ia vrisnin djalin, dhe me që ky ishte vejan, u martua me të. Edhe pse u linden shumë djem, asaj ia mbajti besën, duke i dhënë të birit pjesën më të mirë dhe më të madhe nga prona e tij dhe duke e dashur më shumë se djemtë e vet. Ndreka (Drekale) u martua me të bijën e vojvodë Zhija Perallov nga Kosori. Me atë i lindën djemtë Nikolla dhe Lala. Pas vdekjes së të atit, ky i fundit, Lale Drekalla, nip i Gjon Kastriotit dhe stërgjysh i parë i Drekallëve të Kuçit që i qiten në breza, me ndonjë ndërlikim të vogël tregimtarët Petroviq. Ndonëse rrëfimi i tyre është i përafërt me atë të Mark Milanit,²¹ s'çon peshë se atij i referohen ata mbi prejardhjen e lashtë dhe lidhjet farefisnore me Skënderbeun. Një kuças tjetër, Çedoja, (1933) i ati i të cilit, Novak Radovan Nikeziq u shpërngul nga fshati Bezjovë në Tivar, na tha më 26.9.2005 se e kanë prejardhjen nga vojvodë Nikeza që ishte me prejardhje shqiptare (Arbanas). Dhe, ky Nikeza, nga i cili më vonë trashëgimtarët e morën mbiemrin me formë të sllavizuar – Nikoziç, sipas gojëdhënës ishte i shoqi i dytë i asaj nuseje, që me rastin e ikjes nga pushtuesi e la Gjon Kastrioti, i biri i Skënderbeut. Ky burim tregimtar bie ndesh me burimin historik, sepse Gjon Kastrioti (1455) pas vdekjes së të atit (1468), si fëmijë 13 vjeçar, ende pa u bërë për martesë, mërgoi me t'ëmën e tij, Donikën në Itali. Më vonë u martua dhe i pati tre djem.²² Sido që të jetë puna, kuçasit e sipërpërmendur janë se janë me prejardhje shqiptare. Akademik Mark Krasniqi pohon se shumë malazezë të kolonizuar në Kosovë mbas Luftës së Parë Botërore, ose që jetonin në Beograd, deri vonë, e ndoshta edhe sot, kanë mbajtur në shtëpitë e tyre fotografinë e Skënderbeut pranë fotografisë së anëtarëve të familjes së tyre, ose të figurës së ndonjë shenjti, patronit të fisit. Këngët për Skënderbeun këndoheshin duke i rënë lahutës në trevat malore të fisit Kuç.²³

Kënga si përkushtim

Me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut u zhvilluan sesione shkencore dhe manifestime kulturore që iu dhanë shkas edhe poetëve-rapsodë që t'i thurnin vargje popullore. Me këtë rast u riaktivizua kujtesa popullore për gjithë atë që kishte ditur dhe kishte krijuar që më parë për Skënderbeun.

Shumica e materialeve të tilla u mblodhën nga folkloristët e zellshëm dhe u botuan në numrin e parë të, Gjurmimeve albanologjike – Folklor dhe etnologji” 1/1971, me kryeredaktor prof. Anton Çetën në Institutin e (ri) hapur Albanologjik të Prishtinës (Më tej, Gj.a.-f.et. 1/1971).

Gjergj Popaj nga katundi Shënkoll i Ulqinit,²⁴ me këngën që e thuri vetë, “Pesqind vjet-okanë kalue” prej 40 vargjeve, i qaset në formë kronike kësaj figure të madhe që nuk arriti ta mbulojë harresa me gjithë kapërcimin e atyre shekujve. Është një formë e re në shtjellimin e krijimeve të tilla me temë historike që mbi mbështetje të traditës sajoi vargje tërheqëse. U nis me ndriçimin e të atit të Skënderbeut: “Ksisoj trimash ka pasë moti/, sikur kjo Gjon Kastrioti” (v. 5, 6) dhe u përqendrua te fatosi ynë:” Skënderbegu, trim drague,/ në Shqipni ai paska shkue/, me urti shqiptart i nxit,/ prej Shqipnisë turqit i qiti” (v.17, 18, 19, 20). E paraqet si një strateg që vërtetë i tillë është:”

Fjala e tij n’Shqipni ndigjohej,/ ushtria organizohej (v. 21, 22), i cili e njihte mirë dhe e zbatonte artin ushtarak: “Skënderbeu, me dinakri/ n’kry t’ushtrisë ai paska pri,/ n’qafë t’malit shqiptart i çoi,/ me gurë turqit i mbuloi (v. 33, 34, 35, 36)”, duke përfunduar se:” Kështu me radhë sa herë puno,/ ushtrinë mretit ja mbaroi (v. 37, 38)”. E skaliti me metaforë: trim drague (v. 17); me krahasim: Si petrit (v. 27). Hetohet edhe ndonjë fjalë e gjuhës së njësuar shqipe, si ndikim i kohës kur u thur kënga: me dinakëri (v. 33), në vend se: me dhëlpni, siç e përdor mjedisi gjuhësor i rapsodit. Edhe folja: nxit-i (v.19) është e formës letrare. Të dyja këto i përdori me qëllim që këngës t’i jap përpara.

Kjo këngë dhe shumë të tjera të thura dhe të kënduara nga rapsodë të tjerë u përcollën edhe përmes valëve të emisionit të atëhershëm javor në gjuhën shqipe në Radio Titograd, që i ndiznin ndjenjat e dëgjuesve të flaktë. Në mesin e tyre u dallua edhe një këngë mjaft e bukur që e thuri dhe e këndoi Rexhep Ramë Vataj – Berisha nga fshati Dashinofc i Deçanit që për një kohë punoi si arsimtar në shkollën filllore të Ostrosit (Krajë), më 3 mars 1968, kur asaj iu dha solemnisht emri i këtij heroj kombëtar.

Personaliteti i këtij udhëheqësi tonë të madh u pasqyrua edhe përmes formave të shkurtra të prozës popullore që iu kushtua atij. Sidomos shquhet ajo me titullin “Skënderbeu etshëm”, të cilën e tregoi Pjetër Marku.²⁵ Sipas tekstit të saj, Skënderbeun dhe ushtarët e tij, ndërsa po luftonin me turqit, i kishte marrë etje e madhe. Një

ushtar e kishte gjetur rrëzë një shkëmbi një pikë ujë, për dy orë mezi e mbushi shishen litërshe. Atë, sa erdhi, ia dha Skënderbeut që ta pinte. Por, ky, kur e pa se s'ka për të gjithë, tha:

- Kenka pak për tanë kët ushtri, asnjeri s'ka pse me e pi.

E, si e mori shishen prej ushtarit, ndër sy të gjithëve e solli shishen me grykë poshtë.

Në këtë mënyrë dëshmohet vlera morale e këtij komandanti të lavdishëm dhe të dashur që i çmonte dhe nderonte ushtarët e vet si vetveten. Me ta ndante të mirën dhe të vështirën, duke ua rrëmbyer zemrën.

Dëshmi etnografike.

Jetën dhe bëmat e Skënderbeut tradita popullore e pasqyroj edhe përmes lëndës së pasur etnografike, e cila e plotëson atë Folklorike.

Brirët e dhisë në kapuç

Skënderbeu, si mjeshtër i madh i artit ushtarak nga tradita diti të gjendej në çdo rast. Sipas tregimit “Dhitë me kukmbonë në qafë” të vjelë në fshatin Nikç (Guci),²⁶ Skënderbeu e mori nga turqit kalanë e Gjirokastrës pasi i futi dhitë në veprim.” Pastaj u kujtua, mori nja njëqind dhi, gjithsecilës dhe ja vuni kaj qirën brien. Me dhi i çoi do çobanë. Dhitë murrën shpatin nrejtë kalasë natën. Turqit çpazën batore n'to. Besojshin se janë ushtarë, por dhitë nuk merrshin vesh e ecshin veç përpara. At'here ata u banë vezvese se janë shejtni, at'here e lshuan kalanë. Skënderbeu hini ën kale. Qysh at'here Skënderi i vuni brienat e dhië ën kauç. Kjo kje lufta m'e parë me fitim të math”. Këtë moment vendimtar kaq bukur e pasqyroj bërësi i këtij tregimi saqë është për t'i marrë lakmi.

Në aspektin strategjik është me interes edhe tregimi “Dhitë e egra e zgjuen nga gjumi Skënderbeun”, që është vjelë në Martinaj, në një fshat po ashtu të Gucisë.²⁷ Në të thuhet se Skënderbeun, pasi hyri në shpellë me ushtarë, e zu gjumi: Turqit i hetuan ku janë, jua qitën rrethin lart, tue u avitë prej shpelle. Dhitë e egra, tue ikë pej tyne, hinë ën shpellë te Skeneri. At'herë ata u çuan, nisën dhe pshtuan pa i zënë turqit rop. Pej atë ditë e mrapa Skenderi i vuni brienat e dhisë ën kapuç”.

Orët dhe zanat

Orët dhe zanat në mitologjinë tonë të pasur zënë një vend të rëndësishëm. Në tregimin “Amaneti i nizamit” të shënuar në Martinaj të Gucisë,²⁸ flitet se, ndërsa Skënderbeu po luftonte në Drisht afër Postribës, në dimër me të ftoftë dhe borë iu lodh ushtria prej urie. Në atë çast e ndihmuan ora dhe zana që po kuvendonin në mes veti, “Zana i thotë orës:

- A don m’ë lanë me dekë Skenderi unit a çka do’me ba?

At’here ora i tha:

- Ky nuk ka me dekë kurr.

Kshtu ora e zana iu lutën Zotit, për do ushqim, mej pshtue ushtarët ën Saba’ heret, kur u çuan luftarët, kqyrë nëpër at shpat, shpati ish dej. Plot shpati ish mush mana të pjekuna. U çuan ushtarët e mlodhën mana. Filluan luftën prap edhe fituen. Skenderi e verroi ni nizam.

Nizami i varruem ia la vllaut amanet ç i me jau lanë amanet edhe djelve ç i mos me ardhë ën kët tokë ma.”

Porositë e Skënderbeut

Skënderbeu që me forcat e veta, si edhe në saje të përkrahjes së plotë të masave të gjera, të cilat në të kishin gjetur udhëheqësin që shprehte dëshirat e tyre, edhe sa ishte gjallë u bë legjendë, shembull burrërie e durimit për popullin e vet, simbol i lirisë dhe luftëtar që iu ndihmoi të tjerëve, u detyrua të luftojë kundër pushtuesit nga Lindja (dy sulltanëve të njohur (Muratit II dhe Mehemitit II) si dhe atij nga Perëndimi (kundër intrigave të Venedikut). Ky i fundit e kishte halë në sy forcimin e Skënderbeut. Kujdesej të mbante sundimin e vet në Shqipëri, duke nxjerrë përfitime nga tregtia me turqit në dëm të popullit shqiptar. Në tregimin “Deka e Skenderbeut” që është regjistruar në katundin Nikç të Gucisë²⁹ nga Perëndimi (Italia, përkatësisht Venediku, vër. I.D) i vjen helmimi: ”Dikur ën kohën e Skenderbeut luftuan Shqiptaraët jo veç ën Shqipni, por edhe n’Itali. Barbarët e Italisë ja çuen Skenderit ni zyrk, kozhun, filloi m’u smu”.

Skënderbeu, edhe në këto çast trishtues që po i afrohej vdekja, e mbajti veten. Kur e mori vesh se Shkodrës po i kanosej rreziku nga 15.000 forca turke, sipas F. S. Nolit: ”kryetrimi i sëmurë në shtratin e vdekjes, u përpoq të ngrihej edhe t’i hipte kalit”.³⁰ Sipas tekstit të këtij

tregimi që përputhet edhe me dëshmitë historike³¹ ai i porositi bashkëpunëtorët e tij që të vazhdonin luftë deri në çlirimin përfundimtar:

“Unë jam smutë, luftën prap vazhdonë. Në kjoftë, qi s’un mani, mos u koritni, me thanë turqit:” i thyen shqiptarët”. Po ma mirë a mos me kallzue qi kanë dekë unë. Lypjani mretit kto gjana: asqerin mos m’e dhanë, pasuninë mos me n’e prekë, gjelep mos me lypë për bakti, armët mos me naj marrë (sylafin) edhe me pasë kanunin tonë. Luftuen do dit e panë qi nuk munin me liftue. (Skenderin e lan fshehun). Kur e panë qi s’po shkon lufta pa Skenderin si me ta, banë si u tha Skenderi. Mreti jau forcoi at lутje. Për do kohë e majti edhe besën. Kur me t’vërtetë e panë se ka dekë Skenderim as parit filloi Turqia mej shtyp ën Toskni e bukur vonë në Malsi”.

Janë këto fjalët më të sinqerta dhe këshillat e fundit dobiprurëse që i shpreh komandanti legjendar me një këmbë në varr. Atij më tepër se vetë jeta i dhimbet ajo Shqipëri, e shkreta, që po bie në robëri. Për të përfutuar nga taktika luftarake u jepte zemër që të luftonin. Dhe, kur t’i mbyllën atij sytë, mos të tregonin, në mënyrë që edhe më tej ta ketë armiku frikë. Ta ruanin moralin e lartë shqiptar dhe të luftonin me shpirt. Por me vdekjen e tij çdo gjë mori fund.

Në shenjë zie për Skënderbeun

Jeta e këtij zulmëmadhi kaloi shpejt, pothuaj si një dallgë lumi që derdhet në det. Ai e përfundoi atë nga një vdekje natyrore,³² por ky lajm i rëndë dhe i papritur i trishtoi sidomos shqiptarët mbarë. Siç njofton M.Barleti³³. “Skënderbeu u varros në qytetin e Liris (Lezhë, vër I.D.), në kishin më të madhe të Shën-Nikollit. Ceremonia e varrimit të tij u përcoll me vaj nga të gjithë princat dhe kapedanët”. Vendin shqiptar e mbuloi zia mbarë: “Qysh mbas vdekjes së Gjergjit, na e mbajnë polin e zi si shej jazit...(thot Drane Shkreli prej Bregut të Bunës, lindur më 1897)”. Doktor profesor Bahri Brisku që e shënoi këtë të dhënë me vlerë etnografike dhe folklorike shpjegon se pol-i është një lloj bohje leshi, të cilën e mbajnë vetëm gratë e Bregut të Bunës. Është një lloj bohje e vogël, e ngjyrosur me ngjyrë të zezë e stolisur me disa të qëndisura folklorike në pjesën e sipërme. Vihet prapa, kurse përpara vihet bohçja tjetër më e madhe. Thonë se vetëm gratë e këtij vendi e mbajnë për jaz të Skënderbeut. Përveç Bregut të Bunës, polin e zi nuk-a mbajnë në asnjë fshat të rrethit të Ulqinit.³⁴ Qysh atëherë shestanasit qeleshen e kanë bajtë të mbështjellë me shpenë të zezë, kurse çakçirët me shirit të zi. (Bujun 18/22 tetor 2005 Ulqin, p.9.

Gjurmë në veshjen femrave

Sipas asaj veshjeje, të cilën pas vdekjes së Skënderbeut (1468) e barti me vete në Itali fisi shqiptar, që në vendlindje bante flokët kaçurrel deri në krahë, një stërgjysh i tij Tedori (jetoj rreth vitit 1319) e mori nofkën “Chiscetisi (vuol di trezze). Pikërisht atë veshje të lashtë popullore shqiptare³⁵ që mund të shihej deri më 1860 të kelmendasit në Srem (fshati Nikinci),³⁶ tani e zhdukur fare³⁷ e përqafoi edhe fisi serb³⁸ i mërkotasve (Mrkojevici) flokëgjatë: Li Mirchoe, de Marchois, por Marchoi, ose Marcovich,³⁹ përkatësisht krahinës së Markajve (Markoviqët), që ashtu si Pashtroviquët, Piperët, Gjurashët (Cërnojeviquët) etj. njihet si shqiptare.⁴⁰ Pamal’ok, Ne-Mal’ok – Malok (shqip mal’ dhe sufiksi – ok) ose “malësor” që ia kanë dhënë vetes shqiptarët e Veriut⁴¹ Veshja që vazhdojnë ta bëjnë femrat e kësaj krahine, me dukuri bilinguizmi dhe emërtimin shqiptar, që është bërë modë deri te boshnjakët dhe sipas saj shtëpia e herceg Sandalit (1435) e mori nofkën “Kosaca”⁴² për nga nuanca e bardhë e ngjyrës, sidomos e këmishës dhe e degërmies, është mjaft e afërt me atë të Krajës dhe të Shestanit, që lidhen me kohën skënderbejane.

Veshja e bukur e Krajës dhe e Shestanit,⁴³ tërheqëse dhe karakteristike me ngjyrën e vet të bardhë, siç u tha edhe më parë të cilën edhe në ditë zie ashtu e mbajnë, mendohet se është tipike me atë të Donikë (Andronika) Kastriotit, të shoqes së Skënderbeut, bijës së Gjergj Arianitit: “Petkat e grave tona krajane, me bojë t’bardhë e me kerrsheta(=gërshetë) në krye, si na thotë gojëdhëna se s’kena kurnjifarë dokumenti është visha e t’shoqes Skenderbegut; sikurse janë gratë me t’bardha: Kranja e Shestani, por ma fort Shestani qi ka at’kershët: Ajo (e ka fjalën për Donika Kastriotin, vër.I.D) është vishë kshtu me petka t’bardha; e thonë se petkat e t’shoqes t’Skënderbeut i ka tash vishe e jonë. Është ajo vishë. Kështu na tregonjin t’moçmit tonë: gjyshat, babat, e atane...”⁴⁴

Këtë të dhënë të rrallë, që për herë të parë e takoj dhe publikoj me peshë jashtëzakonisht të madhe shkencore, duhet ndriçuar. Atë e volëm nga familja Junkaj, nga Ljarja e Krajës, me prejardhje, traditë të lashtë dhe përvojë në ruajtjen e kujtesës popullore, e cila nga mesjeta mban titullin e kontit të Ljares e të bujarisë, titull i parë në tërë krahinën e Krajës, që aty nga viti 1290 Junkut ia dha Helena, mbretëresha e Serbisë, Duklës, Shqiptarisë,⁴⁵ përkatësisht e misëve dhe të Ilirikëvet, siç thot Marin Barleti⁴⁶ bashkë me stemën – mëzatin,

që sot është e vetmja familje e cila gëzon titullin e kontit në mbarë hapësirën shqiptare.

Lënda e ngjeshur folklorike dhe etnografike që iu kushtua figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut formoi një traditë të vlefshme që i përballoi kohës për 6 shekuj.

Në krijimet dhe shënimet që e kanë burimin në Ulqin, në Anë të Malit, në Tivar, në Mërkot, në Krajë e Shesta, Malësi të Madhe, Plavë e Guci, që janë pjesë e kulturës popullore shqiptare, është skalitur për bukuri kjo figurë shqiptare me fuqi madhore. Ato ndriçojnë jetën dhe bëmat e tij, luftërat për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Lidhen me qytetet tona të njohura: Shasin, Shkodrën, Lezhën, Krujën, Gjirokastrën etj. Janë të gërshetuara me një stil të rrjedhshëm dhe me shprehje artistike. Në brendi ngërthejnë mjaft dëshmi të burimit tregimtar, të cilat në shumicën e rasteve e përkojnë me të dhëna historike dhe etnografike. Si të tilla kanë edhe vlera njohëse. Në saje të tyre populli ynë, i pushtuar dhe i paarsimuar, sidomos në të kaluarën, e mbajti gjallë emrin e Skënderbeut, që iu tingëllonte aq ëmbël, në kujtesën e vet.

REFERENCAT:

1. Ismail Doda, Skënderbeu (kumtesë në dorëshkrim), 3 mars 1968, f.1,2.
2. Mendohet të jetë fshehur thesari nën Breshtanë, ku kinse, është gdhendur edhe myhyri (vula) në pllakë, dhe në Bardhaj, tëbana të bjeshkëve në Poprat, ku thuhet se po ashtu është gdhendur në pllakë një hajmali e kthyer nga thesari; në disa vende të Koritës (Shih, Stevan Dučić, Život i običaji plemena Kuča, SKA, SEZ, knj.XLVIII, Život i običaji narodni, knjiga 20, Beograd 1931, f.340. Më tej, Ži OPK).
3. Flitet se disa të huaj aty kanë gjetur thesar në një grumbull me arkivole (S. Dučić, Po aty, f.340).
4. Një njeri i huaj aty e ka gjetur një thesar të fshehur (S.Dučič, Po aty, f.340).
5. Një dinoshas e theri kaun në prag të një kishe afër Dinoshës, ku besohet se është i fshehur thesari, por nuk arriti sukses. Sipas S.Duçiçit (Vepër e cituar, 339) myslimanët e kësaj ane (e ka fjalën për shqiptarët e fesë islame). Njësoj si serbët dhe shqiptarët (mendon për shqiptarët e fesë katolike) besojnë për fshehjen dhe gjetjen e thesarit të fshehur.
6. Legjendën e shënova nga dr.Behri Brisku (1933) në Ulqin (Shih, Ismail Doda, Balada krajane e murosjes së gruas (Punim i magistraturës), Universiteti i Kosovës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë 1984, f. 113, 114.
7. Kristo Frashëri, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, jeta dhe vepra (1405-1468), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë 2002. F. 30 (Më tej, GJ.K. S. , jv).
8. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, ASH e RPSSH, Tiranë 1985, f. 964.
9. S.Dučič, ZIOP, vep. e cit. Në 2, 3, 4, 5), f.339, 340.
10. Në mbështetje të marrëveshjes së 20 gushtit 1463 Skënderbeu i kërkoi Senatit të Venedikut, me anën e Pal Engjëllit që ta shpallte atë, ashtu siç ishte premtuar, guvernator (Capitaneus gentium nostrarum illarum partium ipse vero magnificus dominus gubernator)_ kurse birin e tij Gjon Kastriotin komandat të forcave shqiptare-venedikase në Shqipëri, por Sinjoria u përgjigj se këtë premtim do ta

- realizonte kur të formohej ushtria e përbashkët në Shqipëri (K.Frashëri, GJKS, jv (e cit. Në 7, 423).
11. Shih, Historia e popullit shqiptar, Tiranë: Toena, 2002, ASH, Instituti i Historisë, i, f.425,429. (Më tej. HPSH, i).
 12. Ismail Doda, Skënderbeu dhe malazezët, të L. Lucaj etj. “Në prehër të jetës së re” (doracak për nxënës të shkollës fillore prej klasës III deri në klasën VIII), Enti Republikan për Përparimin e Shkollave, Titograd 1976, f. 68, 69.
 13. K.Frashëri, GJKS, jv (e cit. Në 7,10), 258,259.
 14. Tregimin “Ushitari i Skënderbeut” e shënoi prej Zeqir Brucajt nga Vuthaj (Guci) Hasan Gjonbalaj dhe e botoi në “Gjurmime albanologjike - Folklor dhe etnologji”, IAP. Prishtinë 1971, f.211 (Më tej, Gja etj.
 15. Shasi në të kaluarën, nga liqeni i vet, duke kaluar nëpër kanal në Guen, prej andej lidhej me Shkodrën, por edhe përmes rrugës këmbësore mesjetare: Ulqin-Mali i Brisë – Shkodër, e njohur si rruga romane Ulcinium – Scodra.
 16. Marko Rašovič, Pleme Kuci – etnografsko istorijski pregled -, Beograd 1963, f.42.
 17. Stavri N.Naci. Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e bushatlive në gjysmën e dytë të shekullit XVIII (1757-1796), USHT, Inst.i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1964, f.64.
 18. Dushan Petroviqi (1922) që i shpëtoi disa kosovarë të ikur nga masakra e Tivarit (145), më tregoi më 11 korrik 2005.
 19. Vojo Petroviqi (1937), më 18 e 20 prill; 18 korrik dhe 10 tetor 2005 më informoi në Zalef.
 20. Teodor Petroviči, i lindur më 1886 në fshatin Kosor të Kuçit që me prindër më 1892 erdhi si shërbëtor në familje të Mahmut beg Omerbashit në Tivar. Ai më 1.IV.1945 shpëtoi kosovarë të ikur nga masakra e Tivarit.
 21. Shih, Marko Milanov, Sabrana djela 3, Plene Kuči i narodnoj priči i pjesmi, i (Priredio Milorad Stojovič, “Grafički zavod”, Titograd 1967, f.24,25,26.
 22. K. Frashëri, GJKS, jv. (e cit. Në 7,10), f.258.
 23. Mark Krasniqi, Gjenezja Kastriote e disa fiseve shqiptare dhe malazeze sipas traditës popullore. Në: “Simpozium për Skënderbeun Simpozijum o Skenderbegu (9-12 maj 1968), IAP, Prishtinë, 1969, f.268, 269.

24. E shënoi Bahri Brisku, "Gjurmime albanologjike Folklor dhe Etnologji, i, 1971 (cit. Në 14) f.218,219.
25. Rapsod dhe këngëtar i njohur popullor, me prejardhje nga Mirdita, por pas Luftës së Dytë Botërore kryesisht jetoi në treva të Ulqinit. Tregimin e shënoi prej tij Dom Simon Filipaj (Shih, Gja Fe., 1/1971, 210).
26. Tregimin e shënoi nga Nuo Kol Shtyti prej katundit Nikë (Guci) Hasan Gjonbalaj, shih, Gja Fet. 1/1971, f.209.
27. Tregoi Rexh Prelvukaj, kat. Martinaj (Guci), shënoi Hasan Gjonbalaj Shih, Gja. Fet.1/197, f. 209,210.
28. E tregoi Rexh Prelvukaj, e shënoi Hasan Gjonbalaj, Gja Fet. 1/1971,f.211.
29. E tregoi Nuo Kol Shtyti; e shënoi Shaban Gjonbalaj. Shih,Gja fet.1/1971, f.212.
30. Fan S. Noli, Historia e Skënderbeut kryezotit të Arbërisë 1405-1468, Enti i Botimeve të Teksteve të Republikës Socialiste të Serbisë, Beograd, "Rilindja", Prishtinë 1968, f.111.
31. F.S.Noli, Po aty, f.112.
32. Shih G.Frances Chronikon Majus, ed Bonnae 1838, Lib.IV.Kreu XXII,f.438, në: Koço Bozhori, Lufta shqiptaro-turke, etj.,Tiranë 1967, f.108. Cituar sipas K.Frashëri, GJKS,jv (e cit. Në 7,10,22).
33. Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, "Rilindja", Prishtinë, 1967, f. 490 (Më tej, HJVS).
34. Shih, Gja Fet. 1/1971, f.213.
35. Krahaso,Tomashek, Die Thraker 1, 116, Hirt. Indogermanen 2, 461 e 723; Weigand, Zeitsch. Roman. Phl.29 (1905),377. Cituar sipas M.Šufflay, Povijest sjevernih Arbanasa (Sociološka študija), në: Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, knjiga II, Sv.II (1924),Beograd 1925, f.208, shën. 3).
36. Aty luhej pa përcjelljen e ndonjë instrumenti, vetëm nën melodinë e këngës, në të cilën përmendeshin trimëritë e të parëve, posaçërisht të Gjergj Kastriotit Skënderbeut (Shih, Dr.S.K. Popovič, Arnauti u Sremu (Sipas Danilo Kordinlesit) Cituar sipas Frok Zefiq, Shqiptarët Kelmendas në Hrtkocv e Nikinc (137-1997), Zajednica Albanca u Republici Hrvatskoj, Zagreb 1998, Shtypi: Šolta d.o. Zagreb, f.152.

37. Frok Zefia, Shqiptarët Kelmendas, e cituar në sipër, f.145.
38. Markotin me prejardhje serbe, përkatësisht malazeze e paraqet Luka Vujoviči (Luka Vujovič); Markovički dijalekat, SDZ,knj.XIII.Beograd 1969, f.82, kurse tash vonë me kombësi malazeze i paraqt Etem Peroçeviqi (Etem Peročevič), në Školstve u Mrkovičima 1885-2000, Peçuriçe, Osnovna škola “Mrkojeviči”, 2000 (Bar: Fair Print). F.13.
39. (1409-1449, Ljubic, Listina 6,22 e 9, 290 Guistiniani (1553), te Ljubiqi, Commissioni 2, 229, Matkovic, Starine 10 (1878), 251; Ruvarac, Prosvjeta 2 (Cetinje 1893) 312 e 367. Cituar sipas M.Šufflay, Povijest II/2 (e cit. Në 35), f.280, shën.2).
40. Shih, SHPSH, i (e cit, në 11), f.208.
41. M.Šufflay, Povijest, në Arhiv II/2, f.200. shën.3.
42. M.Šufflay, Po atu, f.208.
43. Drita Halimi-Statovci,Disa veshje shqiptare në Mal të Zi, “Gjurmime albanologjike Folklor dhe etnologji” 25-1995, Prishtinë 1996, f.68,69,70,71,72,73,75,76,77,78,79,80,81.
44. Informatë gojore që na dha para mikrofonit më 24.XII.1979 në Ljare Mark Nik Junkaj (23.03.1908-1981) me të shoqen Lenën, e lindur më 21.01.1917 në Dedaj, Shestan.
45. Nga biseda që bënë me të më 24.XII.1979 në Ljare, që e kemi në bobinë magnetofoni në Arkivin personal; Shih edhe, Hajrullah Koliqi, Kraja e Shkodrës, Art Club Ulqin 2001, f.59.
46. Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut (cit. Në 33), f.158:”... mbretëresha Helenë prej Frëngjie, grua fort besimtare, bashkëshorta e mbretit të misëve dhe të Ilirikëvet Simeon Nemanja”.